

## ANEKSI 14

### 14. PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

#### 14.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM

##### 14.1.1. Informacion mbi zhvilluesin

Emri i Kompanisë	<b>“SAKA MOBILJE” Sh.p.k</b>
Adresa e zyrës qendrore të Kompanisë	Tirane, Tirane, TIRANE, Njesia Administrative Vaqarr, prane Shkolles “Kajtazi”, fshati Vaqarr, Tirane
Numri i regjistrimit të Kompanisë(NIPT)	<b>NUIS K71910002U</b>
Kodi kryesor i aktivitetit (sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit nr 10448, date 14.7.2011 “Per lejet e mjedisit”)	a- <u>Veprimtarite e lendes se drurit</u> b- <u>Veprimtari te tjera qe perfshijne perdorimin e solventeve</u>
Përfaqësuesi i autorizuar	JORIDA BEQIRI
Emri dhe Mbiemri	JORIDA BEQIRI
Pozicioni në Kompani	Ekonomiste
Telefoni	<b>068 901 86 67</b>

##### 14.1.2. Informacion mbi Projektin

**Titulli i Projektit:** *Ne procesin e prodhimit te mobiljeve* kryhen proceset e:

- sharrimit, shpimit, ferkimit me rere, gdhendjes, tornimit, zdrukthimit, kujdesit ose trajtimit kimik te drurit;
- lyerje/veshje te aplikuara ne siperfaqe druri.

**Kapaciteti prodhues:** sasia e lendes drusore te perdorur eshte rreth **450 m<sup>3</sup>/vit.**

#### 14.2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

##### a) Përshkrimi i qëllimit të projektit të propozuar

Aktiviteti i deklaruar i Shoqërise është perpunimi i lendes drusore, prodhimi e tregtimi i mobiljeve, i elementeve të drurit, i pajisjeve shtëpijake&zyra etj. destinuar për tregun vendas.

Objekti i Veprimtarisë: *Prodhim dhe tregtim i mobiljeve*

Investitori: SAKA MOBILJE


Vendndodhja: Tirane, Tirane, TIRANE, Njesia Administrative Vaqarr, prane Shkolles “Kajtazi”, fshati Vaqarr, Tirane

Kondicionet urbanistike:

- Siperfaqja e truallit 4500 m<sup>2</sup>
- Siperfaqe ndertimit 1115 m<sup>2</sup>

**b) Planimetria e vendndodhjes së projektit**

**3. Vendndodhja:** Tirane, Tirane, TIRANE, Njesia Administrative Vaqarr, prane Shkolles "Kajtazi", fshati Vaqarr, Tirane.



*Vendndodhja e instalimit "Saka Mobilje", Vaqarr*

Objekti i ndertuar ka te dhena si me poshte:

- |                           |   |
|---------------------------|---|
| - Vendndodhja e objektit: | Fshati Vaqarr, Njesia Administrative Vaqarr |
| - Zona Kadastrale:        | 3712  |
| - Numri i Pasurise:       | 10/7  |
| - Siperfaqen e truallit:  | 4500 m <sup>2</sup>                         |
| - Siperfaqe e ndertimit:  | 1115 m <sup>2</sup>                         |
| - Statusi i truallit:     | Truall                                      |
| - Leja e ndertimit:       | Vendimi i KRRT Nr. 8, date 7.11.2006        |



Foto ajrore e vendndodhjes se Instalimit "Saka Mobilje"

**Koordinatat e Vendndodhjes:**

Koordinatat e objektit sipas **Sistemit Koordinativ UTM (3 veri, 3 Lindje)**


PIKA	KOORDINATAT	
	N	E
1.	41 <sup>0</sup> 17' 31.44"	19 <sup>0</sup> 44' 01.71"
2.	41 <sup>0</sup> 17' 35.18"	19 <sup>0</sup> 44' 08".14
3.	41 <sup>0</sup> 17' 34.57"	19 <sup>0</sup> 44' 08.81"
4.	41 <sup>0</sup> 17' 30.84"	19 <sup>0</sup> 44' 02.40"

Koordinatat e objektit sipas **Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942\_GK\_ZONE\_4**

PIKA	KOORDINATAT	
	X	Y
1.	4393937.4699 m	4573863.5124 m
2.	4394088.7663 m	4573976.7160 m
3.	4394104.0829 m	4573957.6696 m
4.	4393953.2553 m	4573844.7664 m

**c) Skica dhe planimetria e objektit të projektit dhe strukturave të projektit**

Objekti është një godinë 1 kat e ndërtuar në një sipërfaqe trualli prej 4500 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe ndërtimi prej 1115 m<sup>2</sup>. Objekti është i ndërtuar në parcelën me Numur Pasurie 107, sic tregohet në Hartën Treguese të Regjistrimit.



Harta Treguese

ç) Përshkrim i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit

**Nuk do të ketë procese ndërtimore**, pasi objekti me sipërfaqe prej 1115 m<sup>2</sup> dhe truallin rreth saj është pjesë e një objekti të ndërtuar me sipërfaqe trualli prej 4500 m<sup>2</sup>.

Kjo zone eshte konsideruar si zone per aktivite ekonomike jo ndotese. E tere fabrika zen nje siperfaqe prej 4500 m<sup>2</sup>, nga te cilat 1115 m<sup>2</sup> eshte siperfaqe ndertimi. Objekti ndodhet ne nje zone me disa aktivite te tjera ekonomike prane saj. Objekti ka infrastrukture te gatshme duke komunikuar direkt me rrugen dytesore te zones.

Vendi ku kryen aktivitetin "SAKA MOBILJE", ka keto te dhena:

- ka filluar kete aktivitet qe prej 11 vitesh ne kete zone;
- ndodhet ne nje zone ku kryhen aktivite ekonomike te tjera jo ndotese;
- eshte larg zonave te banuara dhe nuk ka ne afersi shtepi banimi;
- nuk ka probleme sociale e mjedisore;
- ka infrastrukture pothuaj se te gatshme;
- vendi eshte i lidhur me rruge automobilistike.

**d) Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja**

Objekti eshte i ndertuar qe ne vitin 2007 dhe sherben si punishte per prodhimin e mobiljeve dhe orendive prej druri, pra objekti ka infrastrukture te gatshme.

Lidhur me **furnizimin me energji elektrike**, eshte lidhur kontrate me OSHEE.

Lidhur me **furnizimin me uje**, ai sigurohet me pus cpimi i hapur ne territorin e objektit. Zona ku ndodhet objekti, dhe i tere fshati, **nuk ka sistem kanalizimi per shkarkimet e ujrave te ndotura urbane**. Ujrat e perdorura shkarkohen direkt **ne gropen septike** e ndertuar brenda objektit, e cila boshatiset periodikisht me autobot nga subjekt i licencuar per kete qellim.

**Komuna ofron sherbimin e grumbullimit te mbetjeve urbane** per zonen, nepermjet nje subjekti privat. Te njejtin sherbim subjekti privat e ofron dhe per mbetjet teknologjike te parrezikshme qe mund te depozitohen ne fushen e depozitimit te mbetjeve urbane.

Objekti eshte i lidhur me rrugen qe pershkron tere zonen, nga rruga nacionale Tirane-Plepa-Durres per ne zonen industrial te fshatin Vaqarr.

**e) Informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit**

Aktiviteti i perpunimit te drurit per prodhimin e mobiljeve dhe orendive prej druri nuk ka lidhje me asnje projekt ekzistues perreth apo prane zones. Objekti ndodhet ne nje zone te fshatit Vaqarr, ku prane tij ka disa aktivite ekonomike jo ndotese si: Mobileri "Tirana", Magazina "Lufra", Shkolla "Kajtazi", Magazina "Arko 2001" etj.

**f) Të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasinë e ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe për mënyrën e sigurimit të tyre**

**Lendet e para**

Sic eshte parashikuar edhe ne planin e biznesit, furnizimi me lende te pare do te behet nga furnitore vendas, mbasi lenda e pare derrase, MDF ose melamin gjendet ne vend. Gjithashtu edhe lendet ndihmese te nevojshme ne proceset e perpunimit te drurit do te sigurohen nga firma vendase.

Lendet e para kryesore qe perdoret ne prodhimin e mobiljeve dhe konsumi i tyre eshte si me poshte:

- Lende drusore rreth	450 m <sup>3</sup> /vit
- Bojra per lyerje me baze uji rreth	5 ton/vit
- Bojra per lyerje me baze solventi rreth	10 ton/vit
- Solvente rreth	2.3 ton/vit
- Llakra te ndryshem rreth	2.6 ton/vit
- Astar rreth	2.5 ton/vit
- Pigmente te ndryshme rreth	0.2 ton/vit

### **Perdorimi i ujit**

Ne procesin e perpunimit te materialeve drusore nuk nevojitet uji si lende e pare. Uji perdoret vetem per procese te pastrimit te mjeteve dhe vendit te punes.

Uji perdoret dhe ne procesin e lyejes per te kapur piklat e mjergulles se bojës ne sistemin e aspirimit te dhomes se lyejes. Ky uje riciklohet, pasi kalon nga sistemi i aspirimit dhe filtrimit te avujve te bojës te krijuara ne dhomen e lyejes per ne gropen e dekantimit. Ketu behet largimi i mbetjes se bojës se grumbulluar ne ujin e filtrimit.

### **Perdorimi i energjise**

Makinerite funksionojne me energjie elektrike dhe objekti ka nje fuqi te instaluar prej 100bkW/ore. Objekti furnizohet me energji elektrike nga rrjeti i zones, duke patur kontrate me OSHEE.

Procesi i perpunimit te drurit nuk kerkon perdorimin e lendeve djegese. Nderkohe per nevojat e stazhionimit te lendes drusore (tharjes), si dhe ngrohjes se mjediseve te punes gjate sezonit te dimrit, ne instalim eshte montuar sistemi i pluhurkapjes (cikloni), ku grumbullohet nje sasi e konsiderueshme pluhur tallashi. Kjo sasi tallashi e grmbulluar nga cikloni perdoret ne kaldajen e instalimit per te prodhuar avull, i cili sherben per tharje te materialit drusor dhe ngrohjen e mjediseve te punes gjate stines se ftohte.

Sasia e karburantit te konsumuar do te jete vetem per automjetet e transportit te lendeve te para dhe produkteve te perfunduara (mobilje, orendi druri).

## **14.3 MENAXHIMI I INSTALIMIT**

Shoqeria ka perfunduar ne vitin 2007 investimin per ndertimin dhe pajisjen me makinerite e duhura te nje reparti te prodhimit te mobiljeve ne Fshatin Vaqarr, Komuna Vaqarr, Rrethi Tirane

**Cikli i punes do te jete me nje nderrese 8 oreshe/dite dhe parashikohet te punohet rreth 300 dite/vit. Numri total i te punesuarve do te jete rreth 37 punonjes.**

Sipas funksioneve qe kryejne dhe detyrave qe kane, stafi i shoqerise ka detyra dhe pergjegjesi te caktuara si meposhte:

- ✚ 1 punonjes merren kryesisht me veprimtarine administrative (administratori);
- ✚ 5 punonjes ne administrate me stafin e perbere prej (ekonomiste, arkitekthe, magazinier)
- ✚ 1 punonjes organizon menaxhimin e gjithe proceseve te punes ne funksion te veprimtarise,

- ✚ 1 punonjes eshte pergjegjes per kontrollin e cilesise, sigurise se impiantit, sigurise mjedisore, sigurise fizike, MNZ dhe sigurise ne pune;
- ✚ 1 punonjes merret me mirembajtjen e makinerive;
- ✚ 28 punonjes merren me perpunimin e lendes drusore dhe prodhimin e mobiljeve.

Përshkruani kushtet e punës, siç tregohet në tabelën në vijim:

<b>KUSHTET E PUNËS</b>					
Numri total i punonjësve	37				
Shpërndarja e punonjësve	ZYRA	PRODHIMI	MIRËMBAJTJ A	MAGAZINIM I	TË TJERA
	7	28	1	1	
Turnet dhe aktivitetet	Zyrat / administrata		Instalimet		
	1		1		
Orët e punës	Zyrat / administrata		Instalimet		
	8		8		
Numri i ditëve të punës në vit	300				
Numri i orëve në vit	2400				
Variacionet sezonale	Nuk ka				
Turnet dhe numri i punëtorëve për turn	Gjatë variacioneve sezonale		Pjesa tjetër e vitit		
	1		1		
Periudhat gjatë të cilave kompania mbyllet	Pushimet		Korrik		
	Ndërprerje të rregullta të funksionimit		Korrik		

#### 14.4 LËNDËT E PARA DHE MATERIALET NDIHMËSE, MATERIALE TË TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NË IMPIANT/INSTALIM

Aktiviteti i prodhimit të mobiljeve konsideron si lende të para materialin drusor dhe si lende ndihmese bojrat, ngjitesat, dorezat, menteshat etj.

##### Lendet e para

Sic eshte parashikuar edhe ne planin e biznesit, furnizimi me lende të para do të bëhet nga furnitore vendas, mbasi lenda e para derrase, MDF ose melamin gjendet ne vend. Gjithashtu edhe lendet ndihmese të nevojshme në proceset e perpunimit të drurit do të sigurohen nga firma vendase.

Lendet e para kryesore që përdoret në prodhimin e mobiljeve dhe konsumi i tyre është si më poshtë:

- Lende drusore rreth 450 m<sup>3</sup>/vit
- Bojra për lyerje me baze uji rreth 5 ton/vit
- Bojra për lyerje me baze solventi rreth 10 ton/vit
- Solvente rreth 2.3 ton/vit
- Llakra të ndryshme rreth 2.6 ton/vit

- Astar rreth 2.5 ton/vit
- Pigmente te ndryshme rreth 0.2 ton/vit

#### 14.5 PËRSHKRIM I NDIKIMEVE NEGATIVE TË RËNDËSISHME TË PROJEKTIT TË PROPOZUAR MBI MJEDISIN

##### **Matrica e identifikimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis gjatë ciklit të prodhimit të mobiljeve**

<b>Operacioni</b>	<b>Ndikimi i mundshëm në mjedis</b>
Marrja e lendeve të para nga tregtuesit dhe transporti për në objektin ku ndodhet impianti	<i>Duke qene se transporti do të bëhet në ambalazhe dhe me mjete të posaçëm dhe të mbyllur mundësia që materialet të perhapen në mjedis gjatë transportit pothuajse nuk ekziston).</i>
Ruajtja apo depozitimi i përkohshëm i lendeve të para deri në trajtimin e tyre	<i>Nëse materialet nuk ruhen të mbuluara dhe në mjedise të mbyllura, ekziston mundësia që sasi minimale lëngjesh të derdhen në tokë në zonën e ruajtjes së lendeve të para para – trajtimit</i>
Perpunimi i lendes drusore në instalim	<i>Nëse nuk përdoren mjetet e posaçme të mbrojtjes në punë gjatë proceseve të perpunimit të lendes drusore, punonjësit mund të dëmtohen për shkak të kontaktit direkt me pluhurat, avujt e solveteve, bojrave dhe nivelit të zhurmave.</i>
Ruajtja dhe depozitimi i përkohshëm pas prodhimit të produkteve përfundimtare	<i>Ruajtja do të bëhet në vendin e magazinimit dhe nuk paraqet asnjë mundësi ndotjeje në mjedis. Punonjësit do të përdorin mjetet e duhura dhe do të zbatojnë procedurën e përcaktuar.</i>
Transporti dhe depozitimi final i mbetjeve në venddepozitim të përcaktuar (në rastin e Tiranës në venddepozitim të Sharrës)	<i>Ne rast të tepërimit të mbetjeve të drurit apo tallashit të drurit, transporti do të bëhet me mjete të posaçme dhe nuk ekziston mundësia e ndotjes apo përhapjes së mbetjeve në mjedis.</i>

Ndikimet në mjedis të aktivitetit të prodhimit të mobiljeve do të konsiderohen të parëndësishme. Ky konkluzion lidhet me faktet e mëposhtme:

- Ndikimet në biodiversitet: Objekti është i ndërtuar, dhe njekohesisht me permassa të vogla, pra fillimi i aktivitetit nuk do të preke mbulesën bimore dhe nderkohe nuk do të ketë ndikime në habitatet e zonës.
- Ndikimet në ujë: Aktiviteti që do të kryhet nga shoqëria “Saka Mobilje” nuk ka kërkesa për ujë teknologjik, dhe as do të ketë shkarkime teknologjike. Uji që përdoret gjatë funksionimit të dhomës së lyejes shërben për kapjen e mjergulles së bojrave të krijuara gjatë procesit të lyejes. Normalisht konsumi i ujit është rreth 100 litra ujë në orë. Në rastin e pajisjes që realizon riqarkullimin e ujit, nevoja për ujë reduktohet në rreth 50 litra ujë në ditë.
- Ndikimet në tokë: Nga aktiviteti i prodhimit të mobiljeve, pas procesit të perpunimit të materialit drusor, mbetjet përfundojnë në silosin e kapjes së pluhurave, e cila do të përdoret për djegie në kaldajën e instalimit. Shoqëria do të lidhë kontratë me firmën që është kontraktuar për pastrimin e Komunes Vaqarr.
- Ndikimet në ajër: Nga aktiviteti i prodhimit të mobiljeve, gjatë proceseve të perpunimit të materialit drusor, nuk shkarkohen pluhura në mjedisin e jashtëm të instalimit. Për këtë qëllim



ne instalim eshte funksional sistemi i aspirimit, i cili i dergon pluhurat e tallashit ne silosin e kapjes se pluhurave.

***Përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve***

Shkarkime te ujrave te ndotura: Aktiviteti qe do te kryhet nga shoqeria “Saka Mobilje” nuk ka kerkesa per uje teknologjik, dhe as do te kete shkarkime teknologjike.

Shkarkime te gazrave dhe pluhurave: Nga aktiviteti i prodhimit te mobiljeve, gjate proceseve te perpunimit te materialit drusor, nuk shkarkohen pluhura ne mjedisin e jashtem te instalimit. Per kete qellim ne instalim eshte funksional sistemi i aspirimit, i cili i dergon pluhurat e tallashit ne silosin e kapjes se pluhurave.

Shkarkime te zhurmave: Makinerite e perpunimit te drurit jane burim zhurme ne nivele deri 75 dB(A). Makinerite jane te instaluar ne mjediset e brendshme te objektit dhe nuk jane gjeneruese e zhurmave per mjedisin e jashtem te instalimit. Nderkohe duhet te kemi parasysh qe jemi plotesisht ne zone e destinuar per zhvillimin e aktiviteve prodhuese.

Shkarkimet e mbetjeve: Nga aktiviteti i prodhimit te mobiljeve, pas procesit te perpunimit te materialit drusor, mbetjet perfundojne ne silosin e kapjes se pluhurave, e cila do te perdoret per djegie ne kaldajen e instalimit. Shoqeria do te lidhe kontrate me firmen qe eshte kontraktuar per pastrimin e Komunes Vaqarr.

***Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar***

Ndikimet e mundshme ne mjedis te aktivitetit te prodhimit te mobiljeve jane pothuaj ne vlera te neglizhueshme. Per keto arsye me nderprerjen e aktivitetit nuk do te kete ndikime te akumuluar, te cilat do te kerkojne kohe qe te humbin ndikimin e tyre ne mjedisin perreth. Ky fakt ben te panevojshme planin e rehabilitimit te mjedisit dhe te territorit pas nderprerjes se aktivitetit.

***Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të***

Nga kryerja e aktivitetit te prodhimit te mobiljeve, sic u tha dhe me lart, i vetmi ndikim ne mjedis eshte sasia e mbetjeve te dala pas procesit te perpunimit te lendes drusore. Procesi i perpunimit te lendes drusore rezulton dhe ne krijimin e mases se mbetjeve deri ne masen 7% te volumit fillestar. Mbetjet jane copra druri dhe tallash druri, e cila digjet ne kaldajen e instalimit per prodhim avulli dhe ngrohje te mjediseve te punes gjate stines se dimrit.

Ne rast te tepricave mbi nevojat e kaldajes se instalimit, ato do te depozitohen ne landfillin e Sharres. Shoqeria do te lidhe kontrate me firmen qe eshte kontraktuar per pastrimin e Komunes Vaqarr.

***Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille)***

Aktiviteti qe zhvillon shoqeria “SAKA MOBILJE” Sh.p.k eshte nje aktivitet me permasa te vogla, si nga siperfaqja e objektit qe ajo perdor, ashtu dhe nga kapaciteti perpunues nga impianti i instaluar (rreth 450 m<sup>3</sup> lende drusore/vit).

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk pritet qe te kete ndikime as ne zonen perreth objektit, per faktin qe nuk do te kete shkarkime ne ajer, uje dhe toke.

Nisur nga keto te dhena, si dhe vendndodhjes se objektit ne brendesi te territorit te vendit, arrijme ne konkluzionin qe nuk pritet te kete ndikime te mundshme ne mjedisin nderkufitar.

**Pergatiten Kerkesen per Leje Mjedis Tipi B:**

**Per "SAKA MOBILJE" Sh.p.k:**

**GANI DELIU**  
**Specialist per VNM dhe Auditim Mjedisor**  
**Nr. 11614 Prot., Nr. Identifikues 217, Date 10.12.2015**

**ARBEN SAKA**  
**(ADMINISTRATOR)**

**OLSI MUCA**  
**Agromjedis**

**FIONA RUSHEKU**  
**Agromjedis**